



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 korrik 2019
Nr. ref.:RK 1400/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI161/18

Parashtrues

Ejup Koci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 105/2018, të 4 majit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ejup Koci nga fshati Polac, komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit Rev. nr. 105/2018 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i kontestuar), të cilin e ka pranuar më 22 qershor 2018, në ndërlidhje me Aktvendimin Ac. nr. 2176/2016 të Gjykatës së Apelit, të 7 shkurtit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 tetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese) Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 30 tetor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi dokumente shtesë, përkatësisht bashkëngjitjen e aktvendimit të kontestuar.
8. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi dorëzoi dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
9. Më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë sërish dokumentacion shtesë, megjithatë dokumentet në fjalë nuk mund të pranohen nga Gjykata për shkak të kalimit të afatit të përcaktuar me rregullin 33 (3) të Rregullores së punës.
10. Më 6 qershor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi parashtron kërkesë për herën e dytë në Gjykatë, lidhur me të njëjtën çështje.

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e parë KI109/17

12. Më 8 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtoi kërkesën KI109/17 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi tejzgjatjen e procedurave, përkatësisht zvarritjen e vendosjes së lëndës civile C. nr. 0355/2011, e cila kishte të bënte me shpronësimin e paluajtshmërive për shkak të ndërtimit të rrugës ndërkomunale Skenderaj-Vushtrri. Parashtruesi, në këtë rast, pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor], në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës.
13. Më 15 nëntor 2017, me kërkesë të Gjykatës, Gjykata e Apelit dorëzoi informata shitesë në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke informuar Gjykatën: “... kjo lëndë me nr. C. nr. 0355/11, me Aktvendim të datës 25.09.2012 Gjykata Komunale në Skenderaj, shpallet jokompetente. Pastaj lënda kalon në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Ky Departament vepron për plotësim të padisë, dhe pastaj kërkon për vendosjen e kompetencës. Gjykata e Apelit e Kosovës me AA. nr. 1/15 të datës 23.04.2015 e cakton Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega Skenderaj për të vendosur, dhe lënda këtu merr numrin C. nr. 145/15, dhe vendoset për atë, me Aktvendimin e datës 14.03.2016 pastaj kemi ankesën kundër këtij aktvendimi dhe lënda tash gjendet te ne për vendosje me numrin Ac. nr. 2176/2016”.
14. Më 30 maj 2018, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, me të cilin konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmoi në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë (gjegjësisht të drejtën në gjykim të drejtë, brenda një afati kohor të arsyeshëm).

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme KI161/18

15. Më 14 mars 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Skenderaj, me Aktvendimin C. nr. 145/2015, vendosi të ndërpresë procedurën kontestimore të iniciuar me padi nga parashtruesi i kërkesës, për shkak se i njëjti nuk e kishte legjitimitetin e palës në procedurë. Kjo sepse trashëgimtare e ngastrave kadastrale lidhur me të cilat ishte iniciuar kontesti gjyqësor, doli të jetë nëna e parashtruesit të kërkesës e cila kishte vdekur në vitin 1991 dhe që nga ajo kohë nuk ishin zhvilluar procedurat e trashëgimisë. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës parashtoi ankesë në Gjykatën e Apelit.
16. Më 7 shkurt 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 2176/2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktvendimin C. nr. 145/2015, të shkallës së parë, të 14 marsit 2016.

17. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural dhe të drejtës materiale.
18. Më 4 maj 2018, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. nr.105/2018, me të cilin e hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën për revizion, për shkak se, në bazë të nenit 228.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit nuk mund të ushtrohej kërkesë për revizion.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese, si më poshtë:
 - 1) E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse:
 - a) nuk i është respektuar e drejta për qasje në gjykatë, sepse Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk morën parasysh provat, përkatësisht ndryshimin e rrethanave të cilat, sipas parashtruesit, nuk mund të ngriheshin në gjykatën e shkallës së parë për shkak të krijimit të rrethanave të mëvonshme të cilat do të kishin ndikim në vendosjen e lëndës;
 - b) i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, për shkak se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk thirrën seancë dëgjimore, duke pretenduar më tej që *“edhe në rastet kur këto gjykata mbajnë seanca dëgjimore nuk i marrin parasysh deklaratat e as provat e prezantuara”*. Ai i referohet në mënyrë specifike seancës së 27 shkurtit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
 - c) i është shkelur e drejta për një vendim në afat të arsyeshëm, sepse lënda për nga natyra nuk është komplekse në vetvete, për faktin se ka të bëjë me shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe se sjellja e tij ishte korrekte në raport me gjykatat e rregullta;
 - 2) E drejta për mjete efektive juridike, sepse Gjykata Supreme duke u thirrur në nenin 228.1 të LPK-së, mohoi këtë të drejtë të garantuar me Kushtetutë dhe Konventë.
 - 3) E drejta në pronë, duke pretenduar se shpronësimi i paluajtshmërive, ngastrave kadastrale të trashëguar nga prindërit ishte joligjor dhe arbitrar.
20. Për më tepër, parashtruesi pretendon se kufizimi i të drejtave, që sipas tij, shkaktohet përmes vendimeve të kontestuarra, është në kundërshtim me nenin 55.5 të Kushtetutës, sepse *“mohojnë esencën e të drejtës së garantuar”*.
21. Parashtruesi nga Gjykata kërkon anulimin si jokushtetuese të aktvendimit të kontestuar, Rev. nr. 105/2018, të Gjykatës Supreme, të aprovojë si të pranueshme kërkesën e tij dhe të konstatojë shkeljen e të drejtave kushtetuese

të sipërpërmendura, si dhe të akordojë kompensim në bazë të nenit 41 të Konventës për dëmet materiale dhe jomateriale të shkaktuara.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që përcaktojnë:

Nenin 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Nenin 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

25. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur përmes akteve konkrete të autoriteteve publike (përkatësisht vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta, të cekura më lart).

26. Megjithatë, Gjykata merr parasysht gjithashtu nenin 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

27. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtuesit, dhe [...].”

28. Në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse është përmbushur kriteri për afatin 4 (katër) mujor, në raport me “vendimin përfundimtar” të nxjerrë si rezultat i “mjetit juridik efektiv,” siç kërkohet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj dhe të qartësuar më tej me Rregullore.
29. Rrjedhimisht, në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse vendimi që kontestohet, përkatësisht Aktvendimi Rev. nr. 105/2018 i Gjykatës Supreme, i 4 majit 2018, është nxjerrë si rezultat i mjetit juridik efektiv. Kjo do të thotë që duhet të vlerësohet nëse kërkesa për revizion e ushtruar kundër Aktvendimit Ac. nr. 2176/2016, të Gjykatës së Apelit, të 7 shkurtit 2018, ishte mjet juridik i lejuar dhe i përcaktuar me ligj.
30. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah se Ligji për Procedurën Kontestimore, përkatësisht neni 228, paragrafi 1, përcakton:

*Revizioni kundër aktvendimit
Neni 228*

*228.1 Palët mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë.
[...]*

31. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim: “Sipas dispozitës së nenit 228.1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Duke marrë parasysh se procedura kontestimore mund të vazhdojë pas përfundimit të procedurës trashëgimore për parcelën kontestuese, aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk e ka kuptimin e aktvendimit të formës së prerë me të cilin përfundon procedura në gjykatën e shkallës së dytë”.

32. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se, duke parashtruar “kërkesë për revizion”, parashtruesi i kërkesës në fakt ka shfrytëzuar një mjet juridik që nuk ishte i paraparë me Ligj. Një gjë e tillë është konfirmuar qartë edhe nga Gjykata Supreme, në aktvendimin e kontestuar. Ky i fundit, megjithatë, nuk është vendim që ndërlidhet me mjetin e fundit efektiv juridik, siç është përcaktuar në rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës në lidhje me kërkesat e nenit 49 [Afatet] të Ligjit.

33. Andaj, Gjykata konsideron se “vendimi përfundimtar”, sa i përket pezullimit të procedurës për shkak të çështjes së legjitimitetit procedural të parashtruesit, sipas kuptimit të rregullit 39 (1) (c) dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, për rastin e parashtruesit, është Aktvendimi Ac. nr. 2176/2018 i Gjykatës së Apelit. Aktvendimi në fjalë i Gjykatës së Apelit është nxjerrë më 7 shkurt 2018, që do të thotë se nga pranimi i tij nga ana e parashtruesit e deri te parashtrimi i kërkesës në Gjykatë, kanë kaluar më tepër se 4 (katër) muaj (Shih, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 36; gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI18/17 me parashtrues *Isuf Bajrami*, i 19 prillit 2018, paragrafi 33, dhe së fundmi rasti KI41/18 me parashtrues *Gordana Dončić*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 shtatorit 2018, paragrafi 40).

34. Gjykata gjithashtu thekson që një qëndrim i tillë është në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata interpreton të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë. Në lidhje me rastin konkret, GJEDNJ ka përcaktuar se veprimet e parashtruesve të kërkesave nuk mund të arsyetohen nëse ata janë përpjekur që të ushtrojnë mjete juridike joadekuate pranë institucioneve a gjykatave të cilat, sipas ligjit, nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ata ankohen (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).

35. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se parashtruesit e kërkesave duhet t'i shterojnë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë, ndër të tjera, efektive. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesit e kërkesave nuk mund të zgjasin afatet kohore të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke përdorur mjete juridike të cilat nuk parashihen (nuk lejohen) me ligj (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i janarit 2006; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31, rasti KI18/17 me parashtrues *Isuf Bajrami*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 19 prillit 2018, paragrafi 37, dhe së fundmi rasti KI41/18 me parashtrues *Gordana Dončić*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 shtatorit 2018, paragrafi 42).

36. Për më tepër, Gjykata thekson se, pas pranimi të Aktvendimit Ac. nr. 2176/2018 të Gjykatës së Apelit, të 7 shkurtit 2018, asgjë nuk e ka penguar parashtruesin e kërkesës për t'iu drejtuar Gjykatës me kërkesë për vlerësimin e

kushtetutshmërisë së aktvendimit në fjalë. Megjithatë, parashtruesi nuk e ka bërë këtë dhe duke shfrytëzuar një mjet juridik të palejuar me ligj, dhe rrjedhimisht joefektiv, ai ka humbur afatin prej 4 (katër) muajsh, për t'iu drejtuar me kërkesë Gjykatës (shih, përshtatshmërisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 35; KI18/17, me parashtrues *Isuf Bajrami*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 19 prillit 2018, paragrafi 38; KI41/18, me parashtrues *Gordana Dončić*, Aktvendimi për papranueshmëri i 26 shtatorit 2018, paragrafi 43).

37. Afati fillon të llogaritet nga vendimi përfundimtar, si rezultat i shterjes së mjeteve juridike të qasshme, adekuate dhe efektive, lidhur me çështjen që është objekt i ankesës (shih, *Norkin kundër Ruisë*, Kërkesa 21056/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih gjithashtu *Moya Alvarez kundër Spanjës*, nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).
38. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'i kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
39. Për më tepër, Gjykata vë në pah argumentin e Gjykatës Supreme se pas zgjidhjes së çështjes së trashëgimisë, gjegjësisht të legjitimitetit procedural të parashtruesit të kërkesës, mund të zhvillohet procedura kontestimore lidhur me shpronësimin e parcelave në fjalë. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se ky vendim i saj nuk paragjykon epilogun eventual të procedurës kontestimore.
40. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme si e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (1) (c) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 6 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi